



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No	05-6617
Nr.faqeve Br.stranica No.pages	-02
Datum: Date:	
17/10/2020	
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF  
HEALTH  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Datë:16/10/2020

Ministri i Shëndetësisë,

Në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë për bazë nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, nenin 8, paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 7 të Rregullores nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e miratuar me Vendimin Nr. 01/03, datë 06.06.2020;

**Qarkore informative nr. 01/2020**

**PËR:** Të gjitha Institucionet qendrore dhe ato lokale, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Shëndetësorë, Inspektoratin Sanitar.

**Qëllimi:** Informimi i institucioneve të lartë cekura lidhur me konkluzionet e takimit të 25 – të nga Komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me koronavirus covid-19

**OBLIGIMET E INSTITUCIONEVE:**

- 1) Të gjitha të punësuarit në institucionet qendrore dhe ato lokale urgjentisht duhet që të repektojnë në përpikmëri udhëzuesin për vendosjen e maskave në mënyrë që të parandalohet përhapja e virusit covid 19.
- 2) Ndalohen seminarët, punëtoritë dhe format e tjera të organizimit ku ka grumbullim njerëzish më shumë se dhjetë persona, si dhe të përdoret forma online e takimeve të punës dhe aktiviteteve të tjera.
- 3) Policia e Kosovës dhe të gjitha inspektoratet pa dallim, bashkë me komunat dhe shtabet emergjente të veprojnë urgjentisht në parandalimin e përkeqësimit të situatës.
- 4) Inspektimet duhet të vazhdojnë me ritëm të shtuar, gjordat të jepen sipas Ligjit për luftimin e pandemisë Covid-19.
- 5) Secili institucion të ketë veprime konkrete dhe në ditët në vijim raportim për aktivitetet e ndërmarra për të parandaluar një valë tjetër, e cila në rrethanat edhe të gripit sezonal dhe virusëve të tjerë eventualë mund të shkaktojnë shumë probleme.

***Qarkorja i dërgohet:***

- Institucioneve qendrore dhe ato lokale
- Policinë e Kosovës
- Inspektoratit Shëndetësorë
- Inspektoratit Sanitar
- Kabinetit të Ministrit
- Udhëheqësit të Departamentit Ligjor
- Arkivit



*Armend Zemaj*

Armend Zemaj

Ministër i Shëndetësisë